# Drive

PORSCHE
ALBANIA
06/14

## Ëndërrojmë ëndrra më të mëdha

*Dreaming bigger dreams*

**F**/Pg. 14




## Një tjetër Vit rekord për VW Group

Another record Year for VW Group

**F**/Pg. 04

## 40 Vitet e Golf

40 Years of Golf

**F**/Pg. 10

## Një risi tunduese

A tempting innovation

**F**/Pg. 16

# Drive 06 /14
with us




## Përmbajtja / Content

**03 - I dashur lexues /** Dear Reader

**04 - Një tjetër Vit rekord për VW Group** / Another record Year for VW Group

**05 - Rezultatet financiare të Porche Holding për vitin 2013** / Porsche Holding's 2013 financial results

**06 - Një rrugë e pashtruar** / An unpaved path

**08 - Fillim i mbarë /** Good Start

**10 - 40 Vjet Golf /** 40 Years of Golf

**12 - Revolucioni i instrumenteve të rrumbullakëta /** The revolution of round instruments

**14 - Ëndërrojmë ëndrra më të mëdha /** Dreaming bigger dreams

**16 - Një risi tunduese /** A tempting innovation

**18 - Teknologjitë e reja /** New Technologies

**20 - Vetëmjaftues /** Self-sufficient

**21 - Teknologji për t'u shijuar /** Technology to enjoy

**22 - Të pastrojmë Shqipërinë /** Cleanse Albania

**23 - GAS Auto /** GAS Auto

Revista Drive është një botim periodik i Porsche Albania.

Realizimi: Botues Porsche Albania,

Realizimi grafik: Sourceone

Burimi: Audi: Audi-Mediaservice.com,
SEAT: media.seat.com,
VW Makina Tregtare: volkswagen-media-services.com,
VW Das Auto Magazine
Skoda: press.skoda-auto.com.

Për komente, pyetje apo sygjerime ju lutem na kontaktoni në office@porsche.al ose në numrin e telefonit: +355 (04) 240 74 30.

Porsche Albania,
Autostrada Tiranë-Durrës, Km. 3, Mëzez.
Telefon: +355 (04) 240 74 30 , Fax.: +355 (04) 240 74 34,
e-mail: office@porsche.al; http://www.porsche.al



# I dashur lexues,
Dear Reader,

Fabian JUNGNITSCH
Drejtor i Përgjithshëm / General Manager
Porsche Albania

*Viti 2014 shënon edhe vitin e tretë të “krizës ekonomike”, ku ritmi i rritjes është tkurrur vazhdimisht dhe vështirësitë po ndihen tashmë nga të gjithë në Shqipëri. Tregu i makinave të reja ka përjetuar gjithashtu vitin e tretë rradhazi të rënies së vazhdueshme edhe pse ritmi i kësaj rënie është ulur në krahasim me vitet e mëparshme. Porsche Albania-s, ashtu si edhe çdo kompani tjetër, i duhet të përshtatet në këtë ambient në mënyrën më të mirë të mundshme. Në këto kohë të vështira, kjo nuk do të ishte e mundur pa bashkëpunëtorët dhe klientët tanë besnikë. Faleminderit për besimin tuaj.*

*Pavarësisht këtij historiku vështirësish, ne kemi përjetuar dhe zhvillime pozitive në kuadër të integrimit të Shqipërisë në Bashkimin Europian, të cilat kulmuan këtë vit me pranimin unanim të të gjithë vendeve të bashkimit Europian që Shqipërisë t'i jepej Statusi i Vendit Kandidat. Ne besojmë se kjo është një arritje e rëndësishme në këtë fazë të zhvillimit të vendit dhe jemi shpresëplotë se nëse vazhdohet në këtë rrugë Shqipëria po hap një derë drejt një të ardhme të begatë me përfitime për çdo qytetar.*

Ndërkohë ethet e kampionatit botëror, të cilat vijnë nga Brazili i largët deri në Shqipëri, prekin jo vetëm sportdashësit, por në sajë të titujve të gazetave, kronikave televizive, reklamave në internet, secilin prej nesh.

Emocioneve të sportit më popullor në planet nuk i shpëtuam as ne në revistën “Drive”. Industria e makinave, edhe pse në dukje e shkëputur nga sporti, në thelb mbështetet tek e njëjta shtysë publike, pasioni. Pasioni për të thyer kufijtë, për të përmirësuar çdo tipar e çdo pritshmëri. Industria e makinave dhe sporti janë ndër polarizuesit më të mëdhenj në preferenca, por njëkohësisht edhe ata që bashkojnë më tepër emocionalisht publikun.

Për të mos humbur asgjë nga ky botëror, Audi ka prezantuar funksionin e ri “Soccer app” ku gjenerata e re e MMI përcjell te ju hap pas hapi çdo detaj të ndeshjes që zhvillohet.

Këtë numër kemi vendosur në kopertinë një ndër modelet më ambicioze të shtëpisë çeke të prodhimit të makinave ŠKODA Octavia RS. Një makinë dinamike dhe emocionuese e cila në më pak se 4.7 m “fsheh” 186 kuaj fuqi. Do të duheshin shumë fjalë për të përshkruar tiparet e kësaj makine, por ka vetëm një mënyrë për ta kuptuar atë, xhiro provë. Ndaj, ju ftojmë ta provoni atë në sallonin tonë.

Në vijim do të flasim për modelin e ri Audi TT të prezantuar në CES (Las Vegas 2014), ku përveç risive në dizajn, entuziastët e pranishëm u tërhoqën edhe nga kroskoti krejtësisht elektronik.

Në këtë numër do të njiheni edhe me përpjekjet që Porsche Albania dhe Shoqata e Distributorëve të Makinave të Reja së bashku me qeverinë shqiptare po bëjnë për të modernizuar tregun e makinave në vend.

Do të bëjmë një ndalesë të shkurtër në punën e shkëlqyer që bënë djemtë dhe vajzat e nismës “Të pastrojmë Shqipërinë në 1 ditë”, një projekt të cilit Albarent dhe Porsche Albania i dhanë më tepër dinamizëm me ŠKODA Yeti-n e ri.

Në faqet në vijim do të keni mundësi të njiheni më tepër me risi teknologjike, kuriozitete, por edhe me informacione praktike mbi markat tona.

Lexim të mbarë!

*2014 has been leading us into the 3rd year of “economic crisis” with shrinking growth and continuously felt hardships for almost everybody in Albania. Also the new car market suffers the third year in a row and indicates currently a lower market than last year although not being reduced to the same extend like in the previous years. Porsche Albania, like every other company, has to cope with this environment to its best abilities. This would not be possible in this difficult times without our valued partners and customers who are loyal to our products and services. Thanks a lot for your trust!*

*Nevertheless, besides the past and present situation we have seen recently significant developments with regards to the integration of Albania into the European context in this year which cumulated with the acceptance of Albania to reach the EU Candidate Association Status jointly approved by all current EU Member states. We believe this to be a milestone in the recent history of Albania and are full of hope and confidence that by continuing this path Albania is opening the door wide to a prosperous future in the benefit of every citizen.*

Meanwhile the World Cup fevers coming from the distant Brazil, do not affect the sport fans only, but each one of us, thanks to headlines, television news and advertising on the Internet.

The thrill of the most popular game on the planet affected even us at "Drive" magazine. The car industry, although seemingly disconnected from sports, in its essence relies on the one public drive – passion: the passion to break boundaries, to improve every feature and every expectation. The car industry and sport are amongst the biggest attractions of individual preferences, but also the ones which unite the public emotionally.

Not to miss anything from this World Cup, Audi has introduced a new function "Soccer app", with the new generation of MMI which provides you with detailed info on the football match being played.

We have chosen one of the most ambitious models of Czech automobile manufacturer, ŠKODA Octavia RS as the cover for this edition. A dynamic and exciting car which "conceals" 186 HP in less than 4.7 m. Describing the features of this car would take thousands of words, but there is only one way to understand it, the test drive . Therefore, we invite you for a drive test at our showroom.

In the following pages we will talk about the new Audi TT introduced at CES (Las Vegas 2014), where apart from the design innovations, the keen participants were also attracted by the entirely electronic dashboard.

In this edition you will be acquainted with the efforts that Porsche Albania and New Cars Dealers Association, in cooperation with the Government of Albania are putting in order to modernize the automotive market in the country.

We will stop shortly on the excellent work that the boys and girls of the "Let's clean Albania in one day" initiative have made. A project which was made more dynamic with the new ŠKODA Yeti from Albarent and Porsche Albania.

In the following pages you shall be acquainted with technology innovations, updates and also with practical information about our brands.

Enjoy!

# Një tjetër Vit rekord për VW Group
## Another record Year for VW Group



Prof. Dr. Martin WINTERKORN.
Kryetar i Bordit Drejtues të Volkswagen AG
Chairman of the Board of Management of Volkswagen AG

"Në vitin 2013 Volkswagen Group shpenzoi më shumë se dhjetë miliardë euro për kërkim dhe zhvillim. Në këtë mënyrë garantojmë pozicionin tonë si lider në teknologji."

"In 2013, the Volkswagen Group spent more than ten billion euros on research and development. We are ensuring our technology leadership this way."

Pavarësisht ambientit të ashpër konkurrues, Volkswagen Group i tejkaloi me sukses objektivat e tij për vitin financiar 2013.

"Viti 2013 për sa i përket industrisë së automobilave i përballi prodhuesit evropianë të makinave me sfida shumë të vështira. Pavarësisht kësaj, Volswagen AG u paraqit në formën e tij më të mirë," tha Drejtori Ekzekutiv, Prof. Dr. Martin Winterkorn.

Në vitin 2013 xhiroja u rrit me 2,2 për qind deri në 197,0 miliardë euro. Të ardhurat e konsoliduara nga operacionet u rritën në një vlerë rekord prej 11,7 miliardë eurosh. Dorëzimet u rritën me 4,9 përqind, duke e shtuar numrin e automjeteve në më shumë se 9,7 milionë.

Përveç kësaj, viti 2014 ka pasur një fillim shumë premtues: në tre muajt e parë kompania ka transportuar afro 2,4 milionë automjete në të gjithë botën. Ky volum i korrespondon një fitimi të barabartë me 5,8 përqind. "Ka shumë shanse që do ta kalojmë shifrën dhjetë milionë dorëzime gjatë këtij viti," përfundoi Winterkorn.

The Volkswagen Group successfully exceeded its goals for the 2013 financial year despite the rigorous competitive environment.

"The 2013 automotive year was extremely challenging for European car manufacturers. Nevertheless, Volkswagen AG presented itself in top form," said CEO Prof. Dr. Martin Winterkorn.

Turnover rose by 2.2 per cent to 197.0 billion euros in 2013. Consolidated income from operations grew to a record value of 11.7 billion euros. Deliveries gained 4.9 per cent, adding up to more than 9.7 million vehicles.

In addition, 2014 is off to a highly promising start: in the first three months, the company shipped roughly 2.4 million vehicles worldwide. This volume corresponds to a gain of 5.8 per cent. "The chances look good that we will surpass the ten-million-deliveries mark during this year," concludes Winterkorn.

# Rezultatet financiare të Porsche Holding për vitin 2013

# Porsche Holding's 2013 financial results

## 2013 viti i rekordeve në shifra

2013 the record year in figures




2013-ta ishte një tjetër vit rekordesh për Porsche Holding Salzburg (PHS). Pavarësisht kushteve të vështira të tregut, xhiroja vjetore e vitit të shkuar arriti në 16,2 miliardë euro. Kjo shifër është e barabartë me një rritje 6,6% në krahasim me një vit më parë.

Në mënyrë të ngjashme, shitjet e makinave të reja dhe të përdorura arritën sërish një nivel maksimal: volumi i shitjeve i rritur me 0,9% përkon me 830,549 makina të shitura. Sipas datës së raportimit 31 dhjetor 2013, në PHS punonin 31,846 punonjës – shifër më e lartë se kurrë më parë. Numri i pikave të shitjes në 23 shtetet ku operon PHS-ja arriti në 570 në fund të vitit

Fjalët e Alain Favey, Drejtor Ekzekutiv dhe zëdhënës i Bordit Drejtues të Porche Holding ishin si vijon: "Jemi shumë të kënaqur me këtë zhvillim dhe me rritjen e pjesës sonë në treg në shumicën e tregjeve. Pavarësisht se në vitin e kaluar Evropa u përball me kushte shumë të vështira, ekipi ynë i dedikuar ia doli sërish që të rrisë performancën. Prandaj dëshiroj që, në emër të kolegëve të mi anëtarë të Bordit Drejtues, të shpreh mirënjohjen time më të thellë për të gjithë punonjësit!

Porsche Holding Salzburg (PHS) enjoyed yet another record year in 2013. Despite the challenging market conditions, last year's turnover soared to 16.2 billion euros. This figure equates to a 6.6% increase in comparison to the prior year.

Sales of new and used cars likewise reached another all time high: the sales volume increased by 0.9% to 830,549 sold vehicles. As at the reporting date of 31 December 2013, 31,846 employees worked at PHS – that is more than ever before. The number of dealership locations in the 23 countries in which PHS operates increased to 570 by year end

In the words of Alain Favey, CEO and Speaker of the Porsche Holding Management Board: "We are highly satisfied with this development and delighted by the increase of our market share in most markets. Even though highly challenging conditions prevailed across broad parts of Europe in the prior year, our dedicated team successfully improved performance once again. Thus, on behalf of my fellow members of the Management Board and myself, I wish to express my deepest gratitude to all employees!"



Gentian BUSHATI Drejtor i Përgjithshëm / General Manager
Porsche Albania

“Takime të ndryshme janë organizuar nga Shoqata e Distributorëve Ligjorë të makinave në Shqipëri me Komisionin për Veprimtaritë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin.”

“Several meetings have taken place with the attendance of the Albanian Legal Dealer Association and the Productive Activity, Trade, and Environment Committee.”

# Një rrugë e pashtruar

# An unpaved path

Mirë se ju gjejmë në këtë numër të parë të revistës tonë “Drive” për vitin 2014: Ju, partnerët tanë, klientët dhe miqtë tanë.

Viti 2013 vazhdoi prirjen rënëse të vërejtur në vitet e fundit në tregun automobilistik shqiptar. Kjo rënie preku kryesisht tregun e makinave të reja, me rreth 19% më pak makina të shitura krahasuar me vitin 2012. Në 2013 janë regjistruar rreth 1603 makina të reja, ndërkohë që numri i makinave të përdorura mbeti në shifrat e një viti më parë me rreth 48 000 makina të regjistruara.

Ecuria në gjashtëmujorin e parë të 2014 tregon që tregu i makinave të reja vazhdon të ndiejë një presion të madh për sa i përket zhvillimit. Në të njëjtën kohë vihet re edhe një rënie e tregut të makinave të përdorura krahasuar me gjashtëmujorin e parë të vitit 2013.

Nëse kërkojmë shkaqet e një prirjeje të tillë negative, mund të përmendim ekonominë e brishtë shqiptare, e cila vlerësohet të ketë një PBB nominale rreth 9,53 miliard Euro (2013) dhe një nivel rritjeje prej 0,7%; borxhin e lartë publik, i cili pati një ndikim të drejtpërdrejtë në investimet direkte si në prodhim, ashtu edhe në shërbime. Nëse i shtojmë kësaj tabloje edhe çrregullimin që iu bë ligjit mbi makinat e përdorura në shtator 2011, atëherë mund të kemi një pamje më të qartë të vështirësive nëpër të cilat po kalon ky treg.

Porsche Albania nëpërmjet revistës “Drive” shpeshherë ka marrë përsipër informimin mbi situatën e tregut automobilistik shqiptar, por këtë herë duam të ndajmë me Ju edhe përpjekjet që ne, si përfaqësues të këtij biznesi po ndërmarrim në bashkëpunim të ngushtë me të gjithë institucionet e vendit, për të përmirësuar këtë situatë ku ky treg ndodhet.

Komuniteti i këtij biznesi, i përfaqësuar denjësisht nga Shoqata e sapo

We are happy to present to you, our partners, customers, and friends, the first issue of our magazine Drive for 2014.

2013 confirmed the downward trend observed in recent years in the Albanian motor vehicle market. This trend mostly affected the new car market with approximately 19% fewer cars sold than in 2012. Approximately 1,603 new motor vehicles were registered in Albania in 2013, while the number of used cars remained the same as that of the preceding year, with 48,000 registered motor vehicles.

As for the market development during the first six-month period of 2014, the figures indicate that the new motor vehicle market continues to be under enormous pressure. A decline was observed at the same time in the used motor vehicle market compared with the same six-month period of 2013.

If we are to look into the causes of such a negative trend, it would be worth mentioning the rather fragile Albanian economy with its nominal GDP at approximately €9.53 billion (2013) and a growth rate of 0.7%. High levels of public debt that had a straightforward impact on direct investments both in production and services are another cause. If we are to add to this to the confusion introduced by amendments to the law on used vehicles in September 2011, we will have a clearer picture of the challenges that this market is facing.

Porsche Albania has often endeavored to inform about the situation of the Albanian motor vehicle market via the “Drive” magazine, but this time we want to share with you the efforts we are undertaking as business representatives in close cooperation with all state institutions with the aim of improving the current situation of the market.

riorganizuar e Distributorëve Ligjorë në Shqipëri, që ka bërë investime që kalojnë shifrat e disa miliona eurove është në kontakte intensive me pushtetin qendror për të bërë ndryshimet e nevojshme ligjore, që në radhë të parë do të rregullonin tregun automotiv shqiptar, e sidomos atë të makinave të përdorura, sigurinë në rrugë, si dhe reduktimin e ndotjes së ambientit nga makinat tepër të vjetra që janë në qarkullim.

Janë organizuar takime të ndryshme nga Shoqata e Distributorëve Ligjorë të makinave në Shqipëri me Komisionin për Veprimtaritë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin, me ministra të ndryshëm, si p.sh. Ministrin e Ekonomisë, Ministrin e Transporteve, si dhe Zv./Ministrin e Financave. Gjej rastin që të falënderoj përfaqësuesit e parlamentit dhe qeverisë për gatishmërinë e shprehur për të na dëgjuar shqetësimet, si dhe sugjerimet për përmirësime nga ana jonë. Takime të tilla kanë pasur në fokus sigurinë rrugore, kjo edhe si politikë e qeverisë shqiptare, formalizimin e tregut të makinave në Shqipëri, si dhe atë të serviseve, rregullimin ligjor të aspektit financiar në mënyrë që shitblerjet e makinave të përdorura të jenë pa kosto shtesë të TVSH-së mbi konsumatorin sa herë që një makinë rishitet ose riblihet, çështjet e ndotjes së ambientit që shkaktojnë makinat e vjetra nëpërmjet çlirimit të $CO_2$ dhe grimcave të tjera ndotëse në atmosferë, çështjen e homologimit të makinave në mënyrë që ato të jenë të standardit evropian.

Besoj që në fokusin e qeverisë shqiptare është rritja e standardeve në këtë sektor, në mënyrë që ato të jenë sa më të përafruara me ato evropiane, por edhe me ato vende që kanë të njëjtat aspirata si Shqipëria, që në një të ardhme të afërt të jemi pjesë e "shtëpisë" së madhe evropiane.

Në këtë kuadër është ngritur një grup pune si nga ministritë e linjës, ashtu edhe nga përfaqësitë e sektorit automotiv shqiptar, për të bërë të mundur një gjë të tillë. Ky projekt do të jetë në vëmendjen e qeverisë shqiptare dhe të vetë Kryeministrit, z. Rama.

Në ketë atmosferë, pritshmëritë tona janë që në një të ardhme të afërt Shqipëria të ketë një standard të ri në sektorin që ne operojmë, në mënyrë që të bëjë të mundur të rritet siguria rrugore, të formalizohet tregu, sidomos ai i makinave të përdorura, por edhe i serviseve; të ketë një ulje kostosh për kompanitë apo individët që sot e kanë shumë të shtrenjtë kthimin e një makine mbrapsht tek koncensionarët, për arsye ligjore. Do të kemi një mjedis më të pastër duke pasur një kontroll më të rreptë dhe me kufi të çlirimit të $CO_2$ në atmosferë nga automjetet, si nga ato të pasagjerëve apo edhe ato të transportit të përzier, apo siç i themi ndryshe, të punës. E gjithë kjo nismë në asnjë rast nuk është fokusuar në kërkesë nga ana jonë për rritje taksash për konsumatorin dhe e thënë në tërësinë e vet, kjo nismë nga biznesi që ne përfaqësojmë do të bëjë të mundur që ambienti ku ne operojmë, klientët apo edhe konsumatorët të kenë përfitime direkte, të cilat do të kenë një ndikim pozitiv mbi të gjitha çështjet e lartpërmendura: siguri në rrugë, kosto më të ulëta, ndotje më të ulët, operacione financiare pa kosto shtesë, standard evropian i makinave në përdorim.

Vetëm në këtë mënyrë, por edhe me shpresën që ekonomia e vendit tonë po njeh dhe do të njohë rritje, mund të përmirësohet cilësia e jetës, do të rritet mobiliteti, biznesi do të prosperojë më shumë dhe do të hapen më shumë vende pune, do të ketë më shumë investime në këtë sektor në mënyrë që standardet që aq shumë ne i kërkojmë të vijnë në nivelin evropian drejt të cilit edhe Shqipëria ka marrë udhën për të qenë pjesë e familjes së bashkuar Ekonomikisht e Politikisht, familjes evropiane.

Deri në takimin e ardhshëm në revistën “Drive” në dhjetor 2014, në emër të Porsche Albania, Ju uroj sa më shumë suksese në gjysmën e dytë të këtij viti.

The business community, duly represented by the newly reorganized Albanian Legal Distributors Association, which has already made multi-million euro investments, is heavily involved with the local government in order to introduce the necessary legal amendments that would, first and foremost, regulate the Albanian automotive market – with a special focus on the used cars market – and would enhance road safety and reduce environmental pollution resulting from the use of very old cars.

Several meetings have taken place with the attendance of the Albanian Legal Distributors Association and the Productive Activity, Trade, and Environment Committee and/or various ministers – for instance, the Minister of Economy, the Minister of Transports, and the Deputy/Minister of Finance. I would also like to take this occasion to express my appreciation and thanks to the representatives of the Parliament and of the Government of Albania for their willingness to listen to our concerns and our suggestions for further improvement. High in the agenda of those meetings was Road Safety – this was also a policy of the Albanian Government; formalization of the motor vehicle market and car service market in Albania; regulation by law of the financial aspects so that the buyer is exempt from the VAT additional costs whenever a used car is sold or purchased; issues related to environmental pollution caused by old cars due to the release of $CO_2$ and other polluting particles; issues relating to the homologation of motor vehicles so that they meet the European standards.

I trust that the focus of the Albanian Government is on the improvement of the standards in this sector in order for them to be as close as possible to the European standards and also to those countries that have similar aspirations as Albania, with a view to becoming, in the near future, part of the extended European 'family'.

A working group with members from line ministries and representatives from the Albanian automotive sector is set up in this context, with a view to achieving the above. This is a project that will be in the focus of the Albanian government and of the Prime Minister, Mr. Rama.

Our expectations are that in the near future, Albania will have new standards in place in the sector in which we operate, so as to ensure the enhancement of Road Safety, market formalization – especially the formalization of the used motor vehicle market and of the service provision market, and the reduction of costs for companies or individuals to whom returning a car to the respective concessionaire would be very costly because of legal reasons. A better environment would be possible, as the release of $CO_2$ from motor vehicles, public transport motor vehicles, or mixed-mode commuting motor vehicles will be strictly checked and limits will be imposed. We never accompanied the above initiative with a tax increase, and, overall, this business initiative will ensure direct benefits for the environment in which we operate, for the client or consumer, and that will have a positive impact on all the issues mentioned hereinabove: Road Safety; lower costs, less pollution, financial transaction without additional costs, and motor vehicles in use that meet the European standards.

Hoping that the country's economy is marking and will mark further growth, it is only in this way that the quality of life will be enhanced, mobility will be improved, businesses will further flourish, possibilities of employment will increase, investments in the sector will grow, and the standards, which we are striving for, will come closer to the European standards. Albania will be heading toward Europe in order to become part of the united European family economically and politically.

On behalf of Porsche Albania, I wish you every success during the second half of the current year, until the next meeting with “Drive” magazine in December 2014.

SIMPLY CLEVER

ŠKODA




**ŠKODA Rapid Spaceback.Hapësira është ndjesi! Këtë verë 135 €/Muaj**

Hyni në ŠKODA Rapid Spaceback dhe gjëja e parë që do t'ju bjerë në sy është hapësira dhe ndriçimi në brendësi. Tavani panoramik opsional së bashku me dritaret e pasme krijojnë këtë ndjesi të veçantë. Edhe pse është modeli i parë hatchback nga ŠKODA, Rapid Spaceback mbart tiparet më të mira të markës ku hapësira në brendësi është një prej tyre. Për të përjetuar ndjesinë ka vetëm një mënyrë! Një xhiro provë!

**www.skoda-auto.al** **facebook.al/skodaalb**

Powered by PORSCHE LEASING

PORSCHE ALBANIA
Autostrada Tirane-Durres, Km. 3,
Tel: +355 (0) 69 20 57 234
www.skoda.al, info@skoda.al

PORSCHE LEASING
Autostrada Tirane-Durres, Km. 3,
Tel: +355 (0) 69 40 66 076
info@porscheleasing.al

KOSTANDIN
Lëvizja Postribës, Shkodër,
Tel: +355 (0) 22 2 11 099
info@kostandingroup.com

E.T.T Group Auto Sh.p.k
Kthesa e Viroit, Gjirokastër
Cel.: +355 (0) 69 40 52 594
ettgroupauto@gmail.com



Ekipi Porsche Leasing Albania
(nga e majta / from left) Marjola GURMA, Fatjon MEDJA, Bora KORMAKU

# Fillim i Mbarë
## A Good Start

Pas një viti në tregun e shërbimeve financiare, ne me kënaqësi e krenari mund të themi se kemi pasur një fillim të mbarë! Strategjia jonë e biznesit konsiston zhvillimin e vazhdueshëm të ofertave financiare dhe modeleve, si dhe në futjen e produkteve krejtësisht të reja të financimit, në tregun e leasing-ut në Shqipëri. Kjo lloj strategjie është njohur dhe pranuar nga klientët tanë, besimi i të cilëve, na krijoi mundësinë për të marrë pozitën e liderit në tregun e Shqipërisë, në financimin e automjeteve për market tona.

Synimi ynë, në kushtet specifike të ekonomisë në të cilat ne punojmë, janë ofertat novatore, si një domosdoshmëri për rritjen e aktivitetit të biznesit. Kjo përbën edhe avantazhin tonë konkurrues. Përveç kësaj, një nga përfitimet më të mëdha e të njohura nga klientët tanë, është shpejtësia e përpunimit dhe miratimit të aplikimeve të financimit. Qëllimi ynë është i thjeshtë dhe ambicioz 24orë deri në aprovimin e financimit . Kjo periudhë, përveç grumbullimit dhe përpunimit të dokumentacionit, do të thotë se edhe nëse nuk janë plotësuar të gjitha kushtet për miratim, ne mund të finalizojmë një përgjigje pozitive për financimin, me parametra dhe kushte të cilat kënaqin nevojat dhe kërkesat e klientëve.

Ne kemi monitoruar tregun e shërbimeve financiare vitin e kaluar, nëpërmjet aktiviteteve të Porsche Albania, importuesit të VW, AUDI, SEAT, ŠKODA dhe Porsche në Shqipëri. Duke marrë në konsideratë, që ne dëshirojmë që të gjitha automjetet nga Porsche Albania, të vihen më shumë në dispozicion për publikun e gjerë duke pëdorur shërbimet tona financiare, ne i ofrojmë klientëve tanë paketa të ndryshme përfitimi. Kjo, në varësi të llojit dhe modelit të automjetit, llojit të financimit që klienti kërkon; leasing financiar ose operacional. Paketat e përfitimeve që janë ofruar kanë qenë të ndryshme, si normat jashtëzakonisht atraktive të interesit dhe paketa që konsiston në përfshirjen e kostove të sigurimit dhe regjistrimit të mbuluara nga kompania jonë, duke reduktuar kostot e shpenzimeve fillestare për klientët tanë.

Koncepti i biznesit që ne përfaqësojmë, nënkupton kryesisht orientim drejt klientit - ofrimin e shërbimeve që i siguron klientëve tanë përmbajtje ndaj nevojave të tyre në nivelin më të lartë, qasje inovative në krijimin dhe dhënien e kushteve të financimit. Këto janë elementet kryesore, që ne na kanë veçuar nga konkurrenca dhe na kanë përcaktuar partner të sigurt në financimin. Strategjia jonë e zhvillimit, do të konsistojë në forcimin dhe zhvillimin e mëtejshëm të këtyre elementeve kyçe në të ardhmen. Fakti që pas nesh, qëndron përvoja dhe ekspertiza e Porsche Bank 'know-how' , na vendos në pozicion, për të vendosur të gjitha parametrat financiarë, në kushte shumë konkurruese dhe modele të përshtatura për nevojat e klientëve tanë.

After a year of doing business in the domestic market we can proudly and joyfully conclude that we had a GOOD START! Porsche Leasing business strategy consists of constant development of financing offers and car models, as well as introduction of entirely new financing products in the Albanian leasing market. This kind of strategy is been recognized and accepted from our clients whose trust allowed us to take the leading position in the Albanian car market financing for our brands.

Our goal, in such specific economic conditions we work in, are innovative offers, which are a prerequisite for business growth. This kind of strategy is our competitive advantage. Beside this, one of the biggest benefits recognized by our clients, is the fairly quick processing and approval of financing applications. Our goal is simple and ambitious - 24h until final financing approval. This term, beside collecting and processing of documentation, implies that even if all the conditions for approval are not met, we may render an affirmative financing answer, under modalities and conditions which satisfy client's needs and demands.

We have monitored the financing services market during the past year, by means of Porsche Albania activities, the Importer of VW, AUDI, SEAT, ŠKODA and PORSCHE in Albania. Since we are willing to make the vehicles from Porsche Albania group more available to the wider public through our financing services, we offer our clients diverse benefit packages, depending on the type and model of a vehicle as well as the type of financing (financial or operational leasing). Different benefit packages were provided, such as extremely attractive interest rates and packages that included coverage of insurance and registration costs, reducing thus our clients initial costs and expenses.

The business concept that we represent, primarily implies client orientation – offering the services that meet our clients` highest level needs, innovative approach in creating and providing financing options. These are the key elements that singled us out from competitors and defined us as confident partner in financing. Our development strategy will consist in strengthening and further development of these key elements in the future. The fact that experience and Porsche Bank know-how stands behind us, enables us to place all the highly competitive financial modalities for models that suit our clients` needs.




# 40 vjet Golf
## 40 Years of Golf






Më 29 mars të vitit 1974, nga linja e montimit doli i pari Volkswagen Golf. Deri tani janë shitur më shumë se 30 milionë automjete të kësaj kryevepre, dhe në të shtatë gjeneratat e saj Golf-i ka qenë pionier i përparimeve teknologjike.

Motorët turbo, motorët me injektim të drejtpërdrejtë, sistemet e drejtimit me energji elektrike ose ato hibride me karikim; ABS-ja, ESC-ja, XDS-ja ose 4MOTION; kontrolli i përshtatur i drejtimit, sistemi i frenimit urgjent në qytet, stabilizimi i rimorkios apo sistemi i frenimit automatik pas përplasjes; kondicioneri automatik, sistemi i zërit Dynaudio, ekrani me prekje me sensor afërsie ose fenerët LED; GTI-a, GTD-a ose GTE-ja – të gjitha këto teknologji dhe tendenca që shohim sot janë reformuar gjithmonë nga Golf-i.

Golf Mk I: Seritë e para të Golf-it dolën nga linja e montimit në Wolfsburg, më 29 mars të vitit 1974. Ndërkohë që Beetle me motorin mbrapa dhe transmisionin për rrotat e pasme mbizotëronte për dekada të tëra, tani ishte momenti i një epoke të re: asaj me motorin e montuar tërthorazi përpara dhe me transmisionin në rrotat e përparme.

Në çdo seri të mëpasshme, Golf-i ka kapërcyer kufijtë e rinj për sa i përket zhvillimeve inxhinierike dhe dizajnit, duke ruajtur ndërkohë konceptin e tij unik.

Më 4 shtator të vitit 2012, Volkswagen shpalli prezantimin global të gjeneratës së shtatë të Golf-it. Pesha e Golf-it të ri u reduktua deri në 100 kg, duke shkuar kundër tendencës së rritjes së peshës, e cila përflitej aq shumë. Si rrjedhim, edhe kursimi i karburantit u rrit deri në 23 për qind. Golf-i i ri TDI BlueMotion konsumon vetëm 3,2 l/100 km. Përveç kësaj, Volkswagen e ka pajisur Golf-in me një armatë të tërë sistemesh të reja ndihmëse ku disa nga to ofrohen si opsione dhe të tjerat në seri.

Golf-i është modeli më i suksesshëm i prodhuar deri më sot nga Volkswagen. Në verën e vitit 2013 u prodhua Golf-i i 30 miliontë.

On March 29, 1974, the very first Volkswagen Golf rolled down the assembly line. More than 30 million vehicles of the best-seller have been sold and from the first to the seventh generation, the Golf has been a pioneer of technological progress.

Whether turbocharged engine, direct-injection engine, electric or plug-in hybrid drive system; whether ABS, ESC, XDS or 4MOTION; whether Adaptive Cruise Control, City Emergency Braking, trailer stabilisation or Automatic Post-Collision Braking System; whether automatic air conditioning, Dynaudio sound system, touchscreen with proximity sensor or LED headlights; whether GTI, GTD or GTE – it was always the Golf through which the most important technologies and trends of our time were democratised.

Golf Mk I: The first series production Golf rolled off the assembly line in Wolfsburg on 29 March 1974. Where for decades the Beetle and thus rear-mounted engines and rear-wheel drive had dominated the scene, a new era had now dawned: that of the transversely mounted front engine and front-wheel drive.

Every next series of Golf has crossed new thresholds in terms of engineering and designs developments while at the same time holding true to its unique concept.

On 4 September 2012, Volkswagen celebrated the world premiere of the seventh generation Golf. The weight of the new Golf was reduced by up to 100 kg, thereby reversing the often cited upward weight spiral. Fuel economy was hence also improved by up to 23 per cent. The new Golf TDI BlueMotion consumes only 3.2 l/100 km. In addition, Volkswagen has equipped the Golf with an entire armada of new assistance systems – some as options and others as standard.

The Golf is the most successful model ever built by Volkswagen. In the summer of 2013 the 30 millionth Golf was built.





# Revolucioni i instrumenteve të rrumbullakëta

## The revolution of round instruments

Audi prezanton të ardhmen e instrumenteve në TT-në e re. Kabina dixhitale e Audi-t përfshin së bashku navigimin, radion, matësin e shpejtësisë, takiometrin dhe telefonin si edhe është e personalizueshme dhe intuitive në përdorim.

Një pamje mahnitëse historie po ndryshon vazhdimisht pas nesh: një ashensor në të cilën makinat elitë në historinë e Audi-t lëvizin në çdo kat të ekspozitës së automobilave të Audi-t në Inglostandt. DKW, Wanderer, Audi V8 dhe Urquattro përpiqen t'ju tërheqin vëmendjen. Megjithatë, ato mund ta kenë vëmendjen tuaj vetëm për një fraksion sekonde. Kjo për shkak se, ndërsa e hidhni shikimin në të kaluarën që kthehet vazhdimisht, kabina virtuale e Audi-t ju lejon të shikoni drejtpërdrejt në të ardhmen.

*Ekran TFT*

Për herë të parë, ky grup instrumentesh dixhitalë revolucionarë del në rrugë me Audi-n e ri TT. Në vend të grupit të sinjaleve paralajmëruese brenda panelit të kontrollit, komponentët kryesorë të të cilit janë dy instrumente rrethore (matësi i shpejtësisë dhe takiometri), tani Audi TT ka vetëm një ekran TFT. Me gjatësi diagonale 12,3 inç, rezolucion pikëzash 1140 x 250 dhe harta me 60 “frames” në sekondë. Ky ekran shfaq çfarëdo që dëshiron shoferi: duke filluar nga hartat e rrugëve, te listat e numrave të telefonit dhe deri tek takiometri i madh në TTS.

Sipas llogaritjeve të Dr. Werner Hamberger nga Departamenti i Sistemeve Operative të Zhvillimit Teknik të Audi-t, në Audi-n e parë TT do të duhej të futeshin disa mijëra harta rrugësh dhe afro 1000 kaseta në mënyrë që të pasqyrohej navigimi dhe hapësira ruajtëse e muzikës së njësisë së re multimedia. Ai ishte udhëheqësi i projektimit të kabinës virtuale. “Ne përdorim ndërfaqen MultiMedia (MMI) si ndërfaqe të përdoruesit, të cilës i kemi hequr dy butona,” shpjegon ai. “Në këtë mënyrë, mund të integrojmë gjithashtu të njëjtën njësi kontrolli në

Audi presents the future of instrumentation in the new TT. The Audi digital cockpit is navigation, radio, speedometer, rev counter and telephone in one – as well as customizable and intuitive to use.

A fascinating historical scene is constantly changing behind us: a paternoster in which the milestones of Audi history ride through every floor of the Audi museum mobile in Ingolstadt. DKW, Wanderer, Audi V8 and Urquattro all try to grab your attention. Yet they can only hold it for a fraction of a second. Because, while you can cast your glance into the past as it turns round and round again, the Audi virtual cockpit lets you stare directly into the future.

*TFT display*

For the first time ever, this revolutionary digital instrument cluster hits the roads in the new Audi TT. Instead of an array of warning signals inside a control panel, whose main components are two round instruments (speedometer and rev counter), the Audi TT now only features a TFT display. It has a diagonal of 12.3 inches, a pixel resolution of 1140 x 250 and maps at 60 frames a second – and this screen displays whatever the driver desires: from the street map to telephone listings, through to a large, dominating rev counter in the TTS.

